



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Obiliq shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Arkiv - Dokumentacionit
Institucioni	Komuna Obiliq
Nr. i Referencës	RN00007958
Kodi	RPC0001764
Data e njoftimit	09.12.2021
Afati për aplikim	31.12.2021 - 11.01.2022

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Pranon lëndët e kryera për arkiv dhe kujdeset për arkivimin dhe i sistemon sipas klasifikimit të lëndëve arkivore dhe shenjave,
- Kryen procedurat e ç, lajmërimin e materialit të pa vlerë –materialit regjistruar nga arkiva sipas afatit të ruajtjes,
- Bënë rregullimin e lëndëve arkivore me revers, lëshon lëndët arkivore dhe udhëheqë evidencën e dhënies së lëndëve nga arkiva,
- U jep ndihmë profesionale palëve në përpilimin e shkresave,
- Koordinon punën me nëpunësit që merren me postën për shpërndarjen e postës, shkresave jashtë,
- Formon data bazën e arkivës në mënyrë elektronike,
- Kryen edhe punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi .



2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e shkollës së mesme apo ekuivalente me to.

Fusha e kërkuar e arsimit : Drejtësi/Histori/Letërsi arkivistik

b) Kualifikime të posaçme formale: Nuk ka.

c) Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet

Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- 1.Njohuritë bazike sipas fushë të arsimit përkatës;
2. Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar
- 3.Aftësi në kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- 4.Aftësi për të punuar në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- 5.Aftësi për të zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- 6.Shkathtësi në komunikim, me stafin të njëjtin nivel brenda institucionit
- 7.Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point);

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0000736	RN00006865	Zyrtar për Arkiv 3	Profesional 4	5	Komuna Obiliq	Spektori Administratë / Komuna e Obiliqit

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

.Aftësi në kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;

.Aftësi për të punuar në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;

Aftësi për të zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

